



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 4662 / prot.

Tiranë, më 29.09.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit
Nr.1051/1, datë 13.06.2017.

SHOQËRISË “KOLOSIAN KRISTAL” SH.P.K

Banesë private 2 katëshe, kati i 2-të, pranë Qafë Kolosian, Bicaj, Kukës

Për dijeni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “KOLOSIAN KRISTAL” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit
Nr. 1051/1, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektin “Përroi Thatë”,
Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 2631
prot., datë 30.06.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 4662
Prot., datë 01.07.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1051/1,
datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektin “Përroi Thatë”, Bashkia
Kukës, Qarku Kukës, pasi në objekt nuk zhvillohet aktivitet minerar prej më shumë se një viti
kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika
1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e
Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar
në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të
revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1051/1, datë 13.06.2017, për mineralin
gëlqeror i mermerizuar, në Objektin “Përroi Thatë”, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, që shoqëria
Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve
kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime
për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1051/1, datë 13.06.2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në Objektin "Përroi Thatë", Bashkia Kukës, Qarku Kukës, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

AMI KOZELI

